



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4776 Prot.

Fushë-Arrëz, më 27.12.2024

VENDIM

Nr.61, datë 23.12.2024

PËR

MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE PËR VITIN 2025

Bazuar në nenin 54 gërma "f", nenin 55 pika 3, të ligjit nr.139/2015 "Për vatëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr.9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në ligjin nr.9920/2008 "Për procedurat tatimore në R.SH", i ndryshuar. Në ligjin nr.10081/2009 "Për liçensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligji nr.10304 datë 15.07.2010 "Për Sektorin minerar Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligji nr.9975 datë 28.07.2008 "Për taksën kombëtare", i ndryshuar, ligjit nr.9482/2006 "Për Legalizimin Urbanizimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, VKM 132/2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluejtshme "ndertesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlersimin alternativ të detyrimit të taksës" i ndryshuar, ligjit nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe zhvillimin e Territorit", ligji nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi" si dhe VKM nr.607 datë 29.07.2020 "Për tarifat dhe llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi". Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 23.12.2024 pas shqyrtimit të projekt-vendimit me 11 këshilltarë të pranishëm,

VENDOSI

1. Të miratojnë nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025, sipas projekt-vendimit dhe ndryshimeve të propozuara nga këshilltarët në mbledhjen plenare të Këshillit të Bashkisë të datës 23.12.2024.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Zyra e Tatim-Taksave pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, Njësitë Administrative, Zyra e Financës dhe Dega Thesarit Pukë.

Miratuar me: 11 Vota pro 0 Vota kundër 0 Vota abstenim

Zbardhur me datë 27.12.2024

Bashkëlidhur këtij Vendimi është relacioni shprehës në lidhje me Paketën Fiskale 2025 të Bashkisë Fushë-Arrëz.

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

